

SPECIFIKIME TEKNIKE TUBAT PE PER KABLLO NENTOKESORE

TUBAT PE PER KABLLO NENTOKESORE(tubo me parete te trasha)

Ilustrimi

(Ilustrime dhe dimensionet jane orientuese)



Pershkrimi

Tubat per instalimin e kablove nentokesore jane te perbere prej polietileni me densitet te larte(HDPE). Ata jane te perbere prej materiali te forte dhe jane projektuar ne menyre te atille qe te durojne ngarkesat e shkaktuara nga toka dhe automjetet. Proceset speciale te prodhimit, sigurojne nje qendrushmeri te larte ndaj shtypjes dhe sforcimeve.

Tubi ka nje siperfaqe te brendeshme dhe te jashtme te lemuar dhe qe ruan vetite ne temperaturat nga -25 deri + 90 °C. Ngjyra standarte e preferuar ne tub duhet te jete e kuqe me nje shirit te bardhe(alternative edhe ngjyre tjeter).

Tubat jane projektuar duke ruajtur metoden konvencionale te montimit- duke e terhequr me tela. Jane veteshuares, rezistent ndaj flakes dhe korozionit.

Tubat per instalimin e kablove ne kanale jane me gjatesi te ndryshme ose ne rulon.

Funksionaliteti I tubave

- Ndertim te shpejte, te pershtatshem dhe me kosto eficente te rrjetave kablore duke perdorur metoden e shpimit horizontal te drejtuar
- Mbrojtje te gjate te kablove te instaluar kunder substancave aggressive te pranishme ne toke
- Zevendesim I shpejte I kablove pa punime shtese

Aplikimi

Tubat per instalimin e kablove nentokesore mund te perdoren per te mbrojtur dhe izoluar kabllo ne instalimet nentokesore duke perdorur metoden e shpimit te drejtuar . Ato jane veçanërisht të përshtatshme për përdorim në sistemet që kërkojnë një forcë të lartë kompresioni (PN10), p.sh. nën rrugë, sheshe, etj

Te dhena teknike

Tipi i tubit	75	90	110	125	160	180	200	250
Diametri i jashtem \varnothing (mm)	75	90	110	125	160	180	200	250
Diametri i brendshem \varnothing (mm)	66.0	79.2	96.8	110.2	141.0	158.6	176.4	220.4
Trashesia e paretit(mm)	4.5	5.4	6.6	7.4	9.5	10.7	11.8	14.8

Mund te perdoren edhe diametra te tjere me kusht qe te plotesohet kushti I durimit te kompresionit si per tubat e tjere.

Standartet

S SH EN 61386-1:2008: Sistemet e tubave për menaxhimin e kabllit - Pjesa 1: Kërkesa të
pergjitheshme

S SH EN 61386-24:2010: Sistemet e tubave për menaxhimin e kabllit - Pjesa 24: Kërkesa të
veçanta - Sistemet e tubave që vendosen nen tokë

DIN 8075 Kerkesat e Pergjitheshme te cilesise se tubave HDPE – Testimi .
ose standarte te tjetre ekuivalent me to

Ambllazhimi

Sipas kerkeses.